

**VENDIM**  
**Nr. 527, datë 22.9.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 587, DATË 22.7.2020, TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË  
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT  
NË NDËRTESA (PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM  
DHE RINDËRTIM NË TË NJËJTIN TRUALL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3, dhe 36, shkronja “a”, pika 1, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. “Në pikën 2.1, shifra “...1 666 179 207 (një miliard e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH...” zëvendësohet me “... 4 666 179 207 (katër miliardë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH...”;

2. “Në pikën 3.1 shifra “... 1 666 179 207 (një miliard e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH...”, zëvendësohet me “... 4 666 179 207 (katër miliardë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH...”;

3. Efekti financiar do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
DHE MINISTËR PËR RINDËRTIMIN  
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE  
Arben Ahmetaj**